

# AKTAKUZA E NGRITUR PËR VEPRAT PENALE KUNDËR RENDIT PUBLIK DHE PENGIMIT TË ADMINISTRIMIT TË DREJTËSISË DHE ADMINISTRATËS PUBLIKE

BULETIN | TETOR 2021

Fondi për të Drejtën Humanitare Kosovë (FDHK) monitoron proceset gjyqësore që zhvillohen pranë Dhomave të Specializuara të Kosovës. FDHK do të publikojë buletine dhe analiza që lidhen me punën e Dhomave të Specializuara të cilat do t'i shërbejnë publikut të gjerë për të qenë më të informuar mbi ecurinë e çështjeve gjyqësore.

## DERI NË QERSHOR TË VITIT 2021 PRANË DHOMAVE TË SPECIALIZUARA TË KOSOVËS (DHSK) JANË NGRITUR **KATËR** AKTAKUZA.

Tre aktakuza janë ngritur për krime lufte ndaj gjashtë (6) personave dhe një aktakuzë është ngritur lidhur me pengimin e administrimit të drejtësisë në rastin Prokurori i Specializuar kundër Hysni Gucatit dhe Nasim Haradinajt.



## JURIDIKSIONI LËNDOR DHE KOHOR I DHOMAVE TË SPECIALIZUARA DHE ZYRËS SË PROKURORIT TË SPECIALIZUAR

Zyra e Prokurorit të Specializuar dhe Dhomat e Specializuar kanë mandat që t'i hetojnë dhe gjykojnë personat për veprat penale të krimeve të luftës dhe krimeve kundër njerëzimit që kanë ndodhur në Kosovë, gjatë periudhës kohore 1 janar të vitit 1998 deri në 31 dhjetor të vitit 2000.

Përveç veprave penale të krimeve të luftës dhe krimeve kundër njerëzimit që kanë ndodhur gjatë periudhës kohore 1998-2000, ZPS dhe DHSK kanë mandat edhe për veprat penale të parashikuara sipas Kodit Penal të Republikës së Kosovës (2012) të cilat mund të kryhen nga momenti i krijimit të DHSK dhe ZPS deri në përfundim të mandatit të tyre:

- Veprat penale kundër administrimit të drejtësisë dhe administratës publike (nenet 384-386, 388, 390-407).
- Veprat penale kundër rendit publik (nenet 409-411, 415, 417, 419, 421).
- Korrupsioni zyrtar dhe veprat penale kundër detyrës zyrtare (nenet 423-424).

# PROKURORI I SPECIALIZUAR KUNDËR HYSNI GUCATIT DHE NASIM HARADINAJT

Aktakuza në rastin Prokurori i Specializuar kundër Hysni Gucatit dhe Nasim Haradinajt është konfirmuar me datën 11 dhjetor të vitit 2020 dhe është bërë publike tre ditë më pas, kurse me datën 5 korrik të vitit 2021 është bërë korigjimi i aktakuzës.

Sipas aktakuzës, midis 7 dhe 25 shtatorit të vitit 2020, në tre konferenca shtypi dhe aktivitete të tjera të transmetuara, si edhe përmes shpërndarjes së mëtejshme, Gucati dhe Haradinaj zbuluan pa autorizim informacion të mbrojtur prej Ligjit të Dhomave të Specializuara, ndër të cilat të dhëna identifikuese të disa dëshmitarëve të mundshëm. Gucati dhe Haradinaj gjithashtu bënë akuza dhe komente nënçmuese kundër dëshmitarëve të mundshëm dhe në mënyrë të përsëritur shprehën synimin e tyre për të dëmtuar punën e Dhomave të Specializuara.

Aktakuza ndaj tyre përmban dy (2) akuza për veprat penale kundër rendit publik:

- Pengim të personave zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare (pika 1 dhe pika 2).

Katër (4) akuza për vepra penale kundër administrimit të drejtësisë dhe administratës publike:

- Frikësim gjatë procedurave penale (pika 3);
- Hakmarrje (pika 4); dhe
- Shkelje të fshehtësisë së procedurës (pika 5 dhe pika 6).

Në të gjitha periudhat që lidhen me këtë aktakuzë, Hysni Gucati ishte kryetar, kurse Nasim Haradinaj ishte nënkryetar i Organizatës së Veteranëve të Lufës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (OVL-UÇK).

Gjatë periudhës në fjalë, në zyrën e OVL-UÇK arritën disa pako me dokumentacion nga një person i paidentifikuar. Ato pako përmbanin dokumentacione konfidenciale të Dhomave të Specializuara të Kosovës. Pas pranimit të tyre, Hysni Gucati dhe Nasim Haradinaj zbuluan informacione të mbrojtura prej Ligjit të Dhomave të Specializuara, përgjatë tre konferencave të shtypit, në datat 7, 16 dhe 22 shtator të vitit 2020. Sipas aktakuzës, ata shpërndanë të dhëna identifikuese edhe të disa dëshmitarëve të mundshëm meqenëse kishin për qëllim dëmtimin e punës së Dhomave të Specializuara, mes tjerash premtuan se do të publikonin çfarëdo informacioni konfidencial dhe jopublik të mëtejshëm që do t'i jepej OVL-UÇK në lidhje me Dhomat e Specializuara dhe Zyrës së Prokurorit të Specializuar (ZPS).

# PARAQITJET E PARA, KONFERENCAT MBI ECURINË E ÇËSHTJES DHE KONFERENCAT PËRNGATITORE PËR GJYKIM

Të pandehurit Hysni Gucati dhe Nasim Haradinaj u arrestuan më 25 shtator të vitit 2020 dhe u transferuan në njësinë e paraburgimit në Hagë-Holandë. Para publikimit të versionit të parë të aktakuzës, të pandehurit u paraqitën vetëm si të dyshuar pranë Dhomave të Specializuara disa ditë pas arrestimit. Me datën 11 dhjetor të vitit 2020 u konfirmua aktakuza ndaj tyre, ata u paraqitën para gjykatësit të procedurës paraprake. Gucati u deklarua i pafajshëm në lidhje me të gjitha pikat e aktakuzës, kurse Haradinaj vendosi të deklarohe brenda 30 ditësh. Sidoqoftë, edhe në paraqitjen/konferencën e radhës Haradinaj nuk u deklarua në lidhje me fajësinë ose pafajësinë e tij, prandaj në rrethana të tilla, sipas Rregullores, konsiderohet se është deklaruar i pafajshëm.

Në periudhën një vjeçare, nga shtatori i vitit 2020 deri në shtator të vitit 2021, në këtë çështje janë mbajtur gjithsej trembëdhjetë (13) seanca. Prej tyre, janë mbajtur katër (4) paraqitjet e para, fillimisht dy (2) paraqitjet e para në cilësinë e të dyshuarve dhe më pas dy (2) në cilësinë e të akuzuarve si dhe gjashtë (6) konferenca tjera mbi ecurinë e çështjes, para gjyqtarit të procedurës paraprake. Pas kalimit të dosjes së çështjes, nga gjyqtari i procedurës paraprake tek trupi gjykues,

janë mbajtur tre (3) konferenca përgatitore për gjykim. Trupi gjykues në këtë rast është krijuar me datën 15 korrik të vitit 2021, në krye me gjyqtarin Charles Smith III.

**MOS DEKLARIMI I TË  
AKUZUARIT LIDHUR ME  
FAJËSINË OSE PAFAJËSINË ME  
RASTIN E LEXIMIT TË  
AKTAKUZËS**

**SIPAS RREGULLORES SË  
PROCEDURËS DHE TË PROVAVE  
TË DHSK, NË QOFTË SE GJATË  
PARAQITJES SË PARË OSE  
PARAQITJEVE VIJUESE, I  
AKUZUARI NUK VETË-  
DEKLAROHET NË LIDHJE ME  
FAJËSINË OSE PAFAJËSINË, NË  
EMËR TË TË AKUZUARIT BËHET  
DEKLARIMI SE ËSHTË I  
PAFAJSHËM.**

**REFUZIMI I TË AKUZUARIT PËR  
TË DEKLARUAR SE ËSHTË  
FAJTOR OSE I PAFAJSHËM NUK  
REZULTON NË NXJERRJEN E  
NJË PËRFUNDIMI NEGATIV  
KUNDËR TIJ.**

# KËRKESAT E MBROJTJES LIDHUR ME VETË-TËRHEQJEN OSE HEQJEN E GJYKATËSVE

Më 26 korrik të vitit 2021, pak kohë pas kalimit të çështjes tek trupi gjykues, mbrojtja e Nasim Haradinajt dorëzoi një kërkesë për vetë-tërheqjen e Kryetares së DHSK, Ekaterina Trendafilova dhe heqjen e nënkryetarit të DHSK, Charles Smith III, i cili është edhe kryetari i trupit gjykues në këtë rast gjyqësor. Kësaj kërkesë pas dy ditëve iu bashkua edhe mbrojtja e Hysni Gucatit.

Kjo kërkesë, ndër të tjera përmbante insistimin për vetë-tërheqjen e Kryetares së DHSK, Ekatarina Trendafilova, nga përmbushja e çdo roli gjyqësor, administrativ ose menaxhues në rastin në fjalë, duke përfshirë këtu edhe caktimin e gjyqtarëve nëpër panelet e ndryshme.

Mbrojtja ka parashtruar disa arsye mbi bazën e së cilave e mbështeste kërkesën si: pjesëmarrja e Kryetares në dy takimet informuese me diplomatë, takimet në të cilin ishte pjesëmarrëse edhe Zyra e Prokurorit të Specializuar. Sipas mbrojtjes, kjo pjesëmarrje nënkupton që e njëjta pajtohej me pretendimet e ZPS-së të parashtruara në atë takim dhe se ekziston rreziku i shpërdorimit të pozitës zyrtare, i përsëkrimit të shtrembëruar të të pandehurve dhe përkrahjes së kauzës së një pale tjetër. Përveç Kryetares, mbrojtja kërkoi edhe tërheqjen e zëvendës kryetarit të Dhomave të Specializuara, Charles Smith III, i cili në të njëjtën kohë është edhe kryetari i trupit gjykues në rastin Prokurori i Specializuar kundër Hysni Gucatit dhe Nasim Haradinajt, që të tërhiqet nga të gjitha detyrat gjyqësore, administrative dhe të menaxhimit të këtij rasti. Arsyetimi i mbrojtjes për tërheqjen e gjyqtarit Charles Smith III është mbështetur në disa deklaratat të një ish-gjykatësi të EULEX-it, deklaratat që i njëjti i ka bërë për këtë gjykatës, gjatë kohës që ky i fundit ishte Kryetar i Asamblesë së Gjykatësve të EULEX-it.

## **Kërkesat u hodhën poshtë nga vetë Kryetarja e Dhomave të Specializuara me arsyetim se:**

-Sa i përket kërkesës së parë që ka të bëjë me takimet informuese të cilat janë mbajtur më 8 dhjetor të vitit 2020 dhe 11 shkurt të vitit 2021, Kryetarja e vlerësoi se ka kaluar afati i parashtrimit të kërkesës, prej dhjetë (10) ditëve, nga momenti kur pala ka qenë në dijeni mbi arsyet për të cilat mbështetet kërkesa. Parashtrimet e mbrojtjes bazohen tërësisht në keqinterpretimet e komenteve të një burimi të pidentifikuar, të bëra gjatë një takimi të zakonshëm. Për këtë arsye, **Kryetarja refuzon të vetë-tërhiqet nga ushtrimi, i funksioneve administrative në këtë çështje** të cilat i ngarkon korniza ligjore.

Sa i përket funksionit gjyqësor, Kryetarja aktualisht nuk kryen asnjë funksion gjyqësor në këtë çështje, për këtë arsye kërkesa e mbrojtjes, **hidhet poshtë**.

-Kurse në lidhje me nënkryetarin Smith III, i cili është edhe kryetar i trupit gjykues në çështjen gjyqësore në fjalë, kërkesa është dorëzuar brenda afatit. Kërkesa për heqjen e tij nga kryetari i trupit gjykues, sipas Kryetares nuk ka qenë e bazuar në fakte por është bazuar në pretendime të përgjithshme të dhëna nga një ish gjykatës i EULEX-it në lidhje me gjykatësin Smith III, kur ai ishte Kryetar i Asamblesë së Gjykatësve të EULEX-it. Sipas Rregullores së Procedurës dhe të Provave të DHSK, kur Kryetari i DHSK gjykon se një kërkesë e tillë është “qëllimkeqe, e gabuar, e pavlerë apo pabazuar”, Kryetari e hedh poshtë kërkesën me procedurë të përshpejtuar, kurse në rrethanat tjera duhet të krijohet paneli prej tre gjyqtarëve për marrjen e një vendimi në lidhje me heqjen e gjyqtarit. Duke u bazuar në këtë të drejtë Kryetarja e **hedhë poshtë kërkesën e mbrojtjes si të pabazuar**.

Shqyrtimi kryesor në këtë lëndë ka filluar në 7 tetor të vitit 2021.

## GJETJET E FDHK

Një numër i konsiderueshëm i dokumentacionit publik i cili është i çastshëm në faqen zyrtare të këtij institucioni gjyqësor nuk është përkthyer i tëri në gjuhën shqipe dhe serbe, por i njëjti publikohet kryesisht vetëm në gjuhën angleze.